



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 2 maj 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Zgjatjen e Afatit të Dorëzimit të Kërkesës për Leje për Apelim dhe Urdhër për Parashtrime të Mëtejshme

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenet 39(1) dhe 45 të Ligjit nr. 05/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 9(5), 77(1), 90(4) dhe 97 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 22 prill 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, me kërkesë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”),² konfirmoi ndryshimet në aktakuzën e konfirmuar³ kundër Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Kadri Veselit (“z. Veseli”), Rexhep Selimit (“z. Selimi”) dhe Jakup Krasniqit (“z. Krasniqi”) (bashkërisht, “të akuzuarit”), urdhëroi ZPS-në të dorëzonte, ndër të tjera, aktakuzën e ndryshuar dhe njoftoi të akuzuarit se do të planifikoheshin paraqitje të mëtejshme të tyre (“Vendimi i Ndryshimit”).⁴

2. Më 28 prill 2022, Mbrojtja e z. Thaçi (“Mbrojtja e Thaçit”) dorëzoi kërkesën për zgjatjen e afatit të dorëzimit të kërkesës për leje për apelim të Vendimit të Ndryshimit (“Kërkesa”),⁵ në të cilën parashtron se temat e ngritura në Vendimin e Ndryshimit janë komplekse dhe se palëve u duhej kohë për të kërkuar udhëzime

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00455, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesë për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-5, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik, përkatësisht F00455/CONF/RED dhe F00455/RED, u dorëzuan më 8 shtator 2021.

³ Versioni i fundit i Aktakuzës së Konfirmuar gjendet në KSC-BC-2020-06, F00455/RED/A01, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Publik i Aktakuzës*, KSC-BC-2020-06/F00455/A01, datë 3 shtator 2021, publik.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00777, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzën kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 22 prill 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 185(a)-(c), (f)-(g). Versioni konfidencial u dorëzua më të njëjtën ditë, F00777/CONF/RED.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00784, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Zgjatje të Afatit të Dorëzimit të Kërkesës për Leje për Apelim të Vendimit mbi Konfirmimin e Ndryshimeve në Aktakuzën kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 28 prill 2022, publike.

të efektshme dhe për të zhvilluar konsultime të brendshme nëse duhej vërtet të ngriheshin disa pika për apelim.⁶ Rrjedhimisht, Mbrojtja e Thaçit argumenton se ekzistojnë arsye të vlefshme për një zgjatje të kufizuar të afatit⁷ deri të hënën, 23 maj 2022.⁸

3. Më 29 prill 2022, ZPS-ja iu përgjigj Kërkesës duke pretenduar se zgjatja e kërkuar e afatit ishte e tepërt por duke ia lënë Gjykatësit të Procedurës Paraprake të vendoste lidhur me zgjatjen e duhur të afatit.⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Sipas nenit 45 të Ligjit, Paneli i Gjykatës së Apelit shqyrton apele të ndërmjetme të paraqitura nga i akuzuari ose nga ZPS-ja në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren. Për apelet e ndërmjetme, përveç atyre që janë vetvetiu të lejueshëm, duhet të miratohet leje nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjykses mbi bazën se kanë të bëjnë me çështje që do të ndikonin ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit dhe për të cilat sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake ose Trupit Gjykses, një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.

5. Sipas nenit 39(1) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencë për të vendosur, ndër të tjera, në lidhje me çdo mocion paraprak.

6. Sipas rregullës 90(4) të Rregullores, Mbrojtjes i jepen njëzet e një (21) ditë për dorëzimin e mocioneve paraprake sipas rregullës 97 të Rregullores në lidhje me akuzat e reja.

⁶ Kërkesa, para. 10, 13.

⁷ Kërkesa, para. 14.

⁸ Kërkesa, para. 9, 15.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00787, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së THAÇIT për Zgjatje të Afatit (F00784)*, 29 prill 2022, publike.

7. Sipas rregullës 9(5) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, nëse i tregohen arsye të vlefshme, mund të shkurtojë afatet e përcaktuara prej Rregullores ose prej panelit.

8. Sipas rregullës 77(1) të Rregullores, në rastet kur një palë kërkon të apelojë një vendim që nuk është vetvetiu i apelueshëm, pala në fjalë i parashtron kërkesë për leje për apelim panelit që ka nxjerrë vendimin e kontestuar, brenda shtatë (7) ditësh prej daljes së vendimit.

III. DISKUTIM

9. Duke pasur parasysh parashtrimet e Thaçit për kompleksitetin e Vendimit të Ndryshimit dhe domosdoshmërinë e marrjes së udhëzimeve dhe zhvillimit të konsultimeve të brendshme, duke pasur parasysh afatin e afërt shtatëditor sipas rregullës 77(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit përkatës të përcaktuar në Rregullore, për t'i dhënë mundësi Mbrojtjes së Thaçit të paraqesë kërkesë për leje për apelim të Vendimit të Ndryshimit. Ky vendim vlen edhe për palët e tjera. Rrjedhimisht, nëse Mbrojtja e Thaçit ose ndonjë palë tjetër vendos të kërkojë leje për apel, ato urdhërohen ta bëjnë këtë deri të hënën, 23 maj 2022.

10. Theksojmë se, sidoqoftë, kjo nuk cenon konstatimin përfundimtar të Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me pranueshmërinë e çfarëdo kërkesë sipas rregullës 77 kundër Vendimit të Ndryshimit. Rrjedhimisht, për të marrë një vendim të bazuar në informacion, Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton Mbrojtjen e Thaçit të sjellë fakte të mëtejshme për argumentet e saj në lidhje me pranueshmërinë e mjetit juridik të parashikuar në rregullën 77, duke pasur parasysh mundësinë procedurale të përcaktuar në rregullën 90(4) të Rregullores. Palët e tjera mund të dorëzojnë parashtrime me shkrim brenda të njëjtit afat të përmendur më lart, nëse dëshirojnë.

IV. VENDIM

11. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **MIRATON** Kërkesën; dhe
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen e Thaçit dhe palët e tjera, që nëse dëshirojnë, të kërkojnë leje për apel deri **të hënë, 23 maj 2022**, duke përfshirë parashtrimet e përcaktuara në paragrafin 10 më lart.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 2 maj 2022
Në Hagë, Holandë.